973

05514

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
ELBASAN

Adresa: Lagja "5 Maji", Rr. "11 Nëntori"

Tel. Fax +3555452912

Nr 211 Prot.

Elbasan, më 29/05/2017

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar

Kërkuesit: **Qendrës "Res Publica", përfaqësuar nga z. Dorian Matlija** –
Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 44
Tiranë

Për dijeni: **Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale – Drejtoria për të Drejtën e Informimit**
Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5
Tiranë

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në përputhje me nenin 11 të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", kërkesën për dhënie informacioni dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit, regjistruar me numër rendor 01, datë 09/05/2017 (sipas regjistrit përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve).

Nga ana jonë ju është nisur shkresa Nr. 1/1 Prot., datë 09/05/2017, e cila është bërë objekt ankimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky organ ka shqyrtuar kërkesën e ankuesit, Qendra "Res Publica" dhe ka dërguar në Prokurorinë Elbasan shkresën Nr. 831/1 Prot., datë 24/05/2017.

Pas shqyrtimit të materialit të sipërcituar ju bëjmë me dije se:

Lidhur me pikën e parë të kërkesës, *numri i kallëzimeve të bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprën penale të "falsifikimit të dokumenteve" për periudhën 2007-2017*, të dhënat statistikore tregojnë se: për vitin 2007 janë regjistruar 21 procedimeve penale; për vitin 2008 janë regjistruar 66 procedime penale; për vitin 2009 janë regjistruar 65 procedime penale; për vitin 2010 janë regjistruar 42 procedime penale; për vitin 2011 janë regjistruar 30 procedime penale; për vitin 2012 janë regjistruar 18 procedime penale; për vitin 2013 janë regjistruar 37 procedime penale; për vitin 2014 janë regjistruar 57 procedime penale; për vitin 2015 janë regjistruar 46 procedime penale; për vitin 2016 janë regjistruar 35 procedime penale; për 3-mujorin e parë të vitit 2017 janë regjistruar 9 procedime penale.

Lidhur me pikën e dytë të kërkesës, *vendimet që janë marrë nga Prokuroria në lidhje me këto kallëzime dhe kopje të vendimeve të marrë për vitet 2007-2017*, ju sqarojmë se:

Aktet dhe informacionet që përmban vendimi që disponon mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes penale janë të dhëna të mbledhura për nevoja të procedimit penal dhe që lidhen me jetën private të subjektit/eve të procedimit dhe personave të tjerë, ku përfshihen interesat financiare, të dhëna personale, të dhëna sensitive, marrëdhënie familjare etj,.

Institucioni i Prokurorisë ka për detyrë të ruajë konfidencialitetin e këtyre të dhënave në zbatim të nenit 8 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet shtesë, Konventën 108 të Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale" dhe Protokollit të saj shtesë, ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Prokurori" miratuar me urdhërin Nr. 122, datë 12/04/2013, ndryshuar me urdhërin Nr. 213, datë 22/07/2016 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nga ana tjetër, në përputhje me nenin 17, pika 1, paragrafi i dytë të ligjit Nr. 119, datë 18/09/2014 "Për të drejtën e informimit", nuk rezulton që titullarët e këtyre të drejtave të kenë dhënë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës.

Nisur nga volumi i dokumentacionit që përfshin objekti i kërkesës dhe në pamundësi objektive për të bërë anonimizimin e të dhënave, nuk mund t'ju vëmë në dispozicion informacionin e kërkuar.

Duke ju falënderuar,

DREJTUESI I PROKURORISË

Dritan GINA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PROKURORIA PRANË GJYKATËS SHKALLËS SË PARË ELBASAN